




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

24/06/2024  
Nr. i Protokollit: 02/ 687

## Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Godanc i Poshtëm dhe i Epërm

E enjte, më 13 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 17:15 – 18:15

Vendi i takimit: SHF “Hasan Prishtina”

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës – Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë Për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi – Gojart Bajrami, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti si dhe Asambleisti -Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

### 1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

**Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu:** Mirë se erdhët në takimin e sotëm, faleminderit që sot keni gjetë kohë që të jeni pjesë e jona. Sot unë këtu jam me Kryetarin e Kuvendit, Adnan Ademi, me Drejtorët, Bardhylin, Gojartin dhe Besnikin, po ashtu me ne është edhe Asamblesiti Besnik Seferi si dhe Gentiana nga kabineti im e cila do të mbajë procesverbalin dhe të gjithë kërkesat e juaja do të shkruaj. Ju e dini që buxheti i komunës ndërtohet nëpër disa faza, faza e parë ku bëhen kërkesa direkt prej qytetarëve është kjo qarkorja e parë buxhetore edhe ne jemi në këtë proces, masandej nga fundi i korrikut nga gushti është qarkorja e dytë edhe në fund detaizohen këto, kalojnë në asamblenë komunale në shtator edhe fillon projektimi i tyre që në pranverën e ardhshme të fillohen dhe të ekzekutohen.

Sot ne jemi këtu që ti marrim kërkesat e juaja për fshatin Godanc, në këtë rast për dy Godancat, sepse shpesh herë e kaluara e ka trajtuar si një fshat e në fakt janë dy fshatra të mëdha. Ju e dini që Godanci ka qenë një thes i shqyer në aspektin e investimeve, sidomos të investimeve kapitale, ku i kemi trashëguar shumë rrugë të pashtruara, ndriçim pothuajse aspak, ju po e shifni edhe shkollën kur është ndërtuar para 20 viteve dhe nuk është bërë as një investim. Tani ju po e shihni që në të gjitha anët është duke u punuar, Shtimja dhe të gjitha fshatrat kanë pësuar ndryshime si shkak i punimeve. Këtu ne jemi për buxhetin lokal ku i kemi afro 11 milion euro këtë vit, prej kësaj shume 50% janë paga dhe mëditje edhe investime kapitale janë 2.4 milion. Ne buxhetin lokal mundohemi ta ndajmë në mënyrë të barabart ashtu siç dhe i kemi premtuar qytetarëve, fshatrat e mëdha mund t'i kërkojnë deri në 100 mij euro, fshatrat e mesëm dikun rreth 80 mijë dhe ato të voglat rreth 60 mijë. Për çdo vit nëse këto shpërndahen në mënyrë të barabart, çdo fshat ka mundësi që ato projekte që i kanë prioritare të realizohen.

Kështu që ne sot këtu jemi për buxhetin komunal dhe fatmirësisht si qeverisje komunale, ku ju po e shihni edhe nëpër media, që ne kemi mbështetjen Qeveritare si asnjëherë më parë, Qeveria e Republikës së Kosovës, është duke e ndihmuar maksimalisht Komunën e Shtimes, dikush po thot që jeni të njëjtës parti dhe prandaj po ndodh kjo mirëpo të njëjtës parti në të kaluarën ka pasur që kanë qenë me dekada dhe prap Shtimen e kanë lënë anash. Ne maksimalisht po mundohemi edhe të sjellim fonde edhe projekte të mira të cilat janë në shërbim të qytetarëve. Sot, edhe një herë presim kërkesa prej jush edhe ato kërkesa që janë të arsyeshme dhe të nevojshme do të mundohemi së bashku që ti përfundojmë.

Faleminderit edhe një herë për kohën të cilën e keni ndarë të jeni pjesë e jona sot, po shpresoj që do të shihemi vetëm për punë të mira dhe për ngjarje të mira.


Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Visar Hamiti: Në rrugën “17 Shkurti”, aneks i kësaj rruge të rregullohen kanalizimi një pjesë 200 metra dhe po ashtu të shtrohet asfalt ose zhavorr.
- Sheq Elezi: Rruga “Kozhinca” të asfaltohet
- Naim Ademi: Në rrugën “Agim Ramadani”, të rregullohet njëra pjesë e anës së lumit e cila nuk është betonuar (50 metra)
- Nazim Hyseni: Kemi probleme me ujin pasi që uji po futet në oborre të shtëpive private, ne jemi në rrugën “Vëllezrit Hyseni”
- Ekrem Ramadani; Në rrugën “Agim Ramadani” të rregullohet ndriçimi
- Nebih Maksuti: Rruga “17 Shkurti”, të zgjerohet dhe të bëhet një park tek fusha “Hajdarit”. Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë a është ndarë buxheti për subvencione në këtë drejtori?
- Adem Ramadani: Të rregullohet kanalizimi i Zborcit i cili po del në lum pasi që nga aroma e keqe nuk mund të qëndrojmë, në atë pjesë lumi të zgjerohet. Uj të pijshëm nuk kemi edhe pse jemi të lidhur në ujësjellës, të bëhet një projekt i ri. Rruga e cila po shtrohet nga Zborci, është mirë që të bëhen disa gypa, aty ku ka dalje për në ara.
- Hyzer Mustafa: Dy rrugë të arave të shtrohen tek segment i rrugës “17 Shkurti”.
- Neriman Ismajli: Kanalet Kulluese në rrugën “ Dëshmorët e Godancit”, deri tek shkolla janë të bllokuara prandaj duhet të hapen dhe të rregullohet kanalizimi po ashtu asfalti në atë pjesë ku është prishur të rregullohet.
- Visar Hamiti: Kemi një parcelë në fshat të cilën ne banorët e njohim si “ Vakaf”, ku është 16 hektar, në atë pjesë po bëhen keqpërdorime të mëdha prandaj nëse mund të bëhet diçka që kjo pjesë të ruhet.

Procesmbajtës,



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Godanc të Poshtëm dhe të Epërm  
Date: 13/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Naim Ademi	
2	Gjerasim Ademi	
3	Uebisr Makubi	
4	SHER ELEZI	
5	Hysen Uraja	
6	EMRUSIT QAMILI	
7	Faton SHAGIRI	
8	Adem Ramadani	
9	Mertel Mustafaj	
10	VISAR HAMITI	
11	Abdyl Ramadani	
12	Ebren Ramadani	
13	Muhamet Qeriqi	
14	Edvart Misini	
15	Ridvan Fazliu	
16	Shaban Shalimi	
17	Waziri Hysoni	

18	Michael Helton	Michael Helton
19	Herman Francis	Herman Francis
20		
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		